



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2157 Prot.

Tiranë, më 01.04. 2020

**URDHËR**

Nr. 101, datë 01.04.2020

**PËR**

**MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. Mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike, deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019, sipas urdhrin të miratuar të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 216, datë 01.04.2020 “Për një ndryshim në urdhrin nr.190, datë 19.03.2020 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve, për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019””.
2. Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 97, datë 19.03.2020 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe Institucionet Arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
  
**BESA SHAHINI**

